

Apelet Retorike

Një ligjratë ka tre përbasë: *folësin, subjektin e bisedës, dhe audiencën*. Prandaj, thotë Aristoteli, ka vetëm tri mënyra bindieje, ethosin (karakterin e folësit), logosin (logjikën e argumentit), dhe pathosin (emocionet e audiencës).

Kështu *karakteri* i folësit (ethosi), vlera e *argumentit* (logosi) dhe gjendja *emocionale* e audiencës (pathosi) ndikojnë mbë rezultatin e një ligjrate, shkrimi, a veprë pamore. Por, pyetja është, si e arrin retori këtë ndikim?

- **Ethosi.** Audiencia i beson autorit (retorit) kur ajo beson që ai ka karakterin, ekspertizën, ose përvojën e duhur, domethanë, është emocionalisht i lidhur me çashtjen, është ekspert në atë çashtje, dhe e ka përjetua situatën.
- **Logosi.** Kur evidenca është korrekte, e mjaftueshme, dhe e lidhur me subjektin në diskutim; kur autori e lidhë evidencën me arsyetimin, atëherë audiencia i beson autorit.
- **Pathosi.** Pathosi mund të thjeshtohet në dy fjalë; drojë e dojë. Në qoftë se autori arrin ta bindi audiencën se shtegu i tij çon drejt dojës e kundër drojës, atëbotë, audiencia do ta dëgjojë atë. Në fakt, audiencia do të veprojë në favor të tij, p.sh. të votojë për të, të ndjeki shfaqjen e tij, të blejë produktet që ai shet, e të tjera

Morali i autorit duhet të përkojë me atë të audiencës. Audiencia duhet ta pranojë ligjikën e argumentit si të arsyeshme. Emocionet e autorit, veçsisht droja e doja, duhet të përkojnë me ato të audiencës; të dy palët duhet që, afërsisht, t'u tremben të njëjëtave gjana dhe të duan të njëjëtave gjana. Përkimi autentik është i dëshirueshëm, por në fund të fundit është detyra e autorit që ta zdrisi këtë përkim; që t'a bindi audiencën që ai, ashtu si audiencia, zbaton të njëjëtat parime morale e kulturore, logjikon në të njëjëtën mënyrë si audiencia, dhe dron e don të njëjëtave gjana.

Audiencia nuk i beson as *të pabesit*, as *të paarsyeshmit*, as *të pandjesishmit*.

Cilsitë kryesore të tri apeleve përfshijnë:

- ethosi: *ekspertizë, përvojë, moral të shëndoshë*
- logosi: *arsyetim i shëndoshë, veçsisht në një gjuhë që audiencia e kupton dhe e aprovon*
- ethosi: *droja dhe doja e autorit duhet të përkojnë me ato të audiencës.*

Apelet bindëse

Shkrimi më i herëshëm retorik në traditën shqipe (megjithëse jo në shqip) mbetet fjalimi i Gjergj Kastriotit para shqiptarëve të çliruom. Më poshtë jepet një pjesë e këtij fjalimi, i cili është përshtatur sipas:

- gjuhës së Buzukut, i cili u pat lemë një shekull më vonë: **uo** < (ua, ue)

- fonolektit qendror: (ǎ, ǝ) > o

- minus rotacizëm

Lirinë nuk ua solla un! Lirinë e gjeta në mes jush. Sapo më shkeli komba në truallin tuoj, sapo ju dëgjuot emënin tem, ishit ju që m'u derdhët me vrap, të tanë; më dolët përpara kush e kush mo parë, sikur të kishit dëgjuom se u ngritën prej vorrit etënit, vëllazënit, e bijtë tuoj; sikur të kishin zbritun këtu të tona Perënditë. Ju më latë prapa, ju m'i lidhët menjëherë duort, ju më mbytët me shërbime aq të mëdha dhe me një gaz shpirtënor aq të modh, saqë duket se ju më kepi bomë tash aq rob sa edhe të lirë.

Në këtë apelim para audiencës së tij, Gjergj Kastrioti tregon që ai ka karakter të naltë (ethos), arsyeton se ai nuk duhet t'i marri të gjitha meritat për çlirimin e Krujës (logos), dhe i njësion ndjenjat e tij me ato të audiencës (pathos).

ethos (thjeshtsia): *Lirinë e gjeta mes jush.*

logos (arsyetimi): *Ju më ndoqët sepse ju vetë po kërkonit lirinë.*

pathos (njësimi i qëllimeve): *Ndjehem rob prej mirsive tuaja.*

Ethosi

Në diskursin retorik, ethos quhet apeli ndaj karakterit të retorit. Retori duhet të ketë *ekspertizë, përvojë, dhe karakter të shëndoshë*. Ai që i përmbushë këto kondita, fiton aprovimin e audiencës. Veçsisht, retori nuk duhet të njihet për *i pabesë*.

Shum ligjruer i nisin fjalimet e tyre me një pjesë të shkurtë që zbulon karakterin e tyre dhe që cakton të fitojë pëlqimin a audiencës, p.sh., ata mund të nisin ligjratën me një barcaletë. Pastaj, pa theksim të tepruom, ata mund të përmendin si në kalim edhe kreditet e tyre—*shkollimin, përvojën, dhe forcën e karakterit*.

Përvoja (ethos):

1. Shumica e klientëve tanë fajsojnë internetin për shum probleme në marrdhanjet me të afërmit e tyre.

Ekspertiza me nam të mirë (ethos + logos):

2. Universiteti X fajson internetin për problemet në marrdhanjet në mes adoleshentëve.

Kualifikimi i argumentit:

Në kapitullin e logjikës flitet për njëfarë skajizmi a zgriptimi (fanatizmi) që del prej asertash që nisin me *'gjitbmonë, gjithkush, të tanë, kurr, askush'*, e të tjera. Në logjikë këto quhen terma të shpërndame sepse ato përfshijnë të gjith antarët e një klase. Audiencia e retorikës është më pak specifike. Asaj i pëlqejnë më shumë aserta që nisin me fjalë si: *disa, një pjesë, etj*. Prandaj,

3. *Kërkimet në universitetin X tregojnë që disa persona preken më lehtëazi prej stresit se shumica e popullsisë.*

Kundër-argumenti:

Këtu autorit i kërkohet me parashikua kundërshtitë, dhe me ndërtua një argument kundër tyre.

Përvoja (ethos + pathos):

Pasqë i bleva tim biri një kompjuter, ai u mbyll në dhomë për dy jave.

Dialekti a zhargoni:

Me shpresë që të afrohen me audiencën, dhe me cak të mos japin përshtypjen se po i flasin audiencës prej stomit, retorët mund të huazojnë fjalë e shprehje lokale. Por, kur kjo teprohet, autori tingllon si hipokrit.

Imagjino në Pejanë që kur ndodhet para tiranasve flet ne dialektin e Shqipnisë së Mesëme.

Toni:

Zgjedhja e fjalëve dhe shprehjeve ndihmon në formulimin e tonit të retorit. Është e randsishëme që audienca të mos e përceptojë tonin si fyes, vulgar, ose të pakandëshëm.

Logosi

Logosi ka një frymë jo vetëm intelektuale por edhe akademike. Tipikisht, kur flitet për logosin, flitet për logjikën, ligjet e arsyes, koherencën, e të tjera. Në situatën retorike flitet për evidencë joerrtare (en. fact-checking) dhe arsyetim që i lidhë evidencën me arsyen në mënyrë koherente (logjike).

Audienca bindet më lehtësisht kur ajo beson që argumenti provohet arsyetisht e plotsisht, dhe mbështetet në kërkime prej institucionesh të besueshme. Trajtimi i argumentit në këtë mënyrë ndihmon edhe apelimin ndaj logosit edhe apelimin ndaj ethosit sepse burimet e besueshme ngrisin edhe vlerën e argumentit edhe kredibilitetin e retorit.

Pathosi

Audienca ka nevojë të dëgjojë rreth preokupimeve kryesore të saj—drojës e dojës. Ajo shpreson që retorë jo vetëm që preokupohet për të njëjetat gjana por ka edhe një zgjidhje të arsyeshme për to. Këtu vërehet se si pathosi (ndjenjat) lidhet me logosin (arsyen) dhe ethosin (ekspertizën).

Retorë i shkolluom din diçka që audiencës mund të mos i shkojë në mendje: energjia aktive, veçsisht kur flitet për masat e gjana, vjen prej emocioneve, jo mendimeve.

Prandaj, caku i retorit (jo dialektistit a silogjistit) është qe: s'pari t'a eksitojë audiencën, pastaj ta shtyjë atë me krye një veprim; p.sh., me votua për të. Bazuom në këtë të vërtetë dhe indinjuom prej retorikës mashtruese, disa analizues theksojnë aspektin emocional të pathosit, duke e paraqitë atë si esenca e retorikës. Sipas këtyne bindiejeve, retorika është manipulim emocionesh, dhe asgjë tjetër. Kjo pikpamje përkon me pikpamjen e Platonint, por jo të Aristotelit. Aristoteli e shihte retorikën si të pazëvendësueshme në funksionin e saj.

1. Në dramën e Shekspirit *Jul Qezari*, Mark Antoni i kthen romakët në anë të Qezarit duke ua përshkrua atyne plagët e Qezarit një nga një, me një gjuhë të gjallë shqisore, të pendsuome me përshkrimin e vrasjes tradhëtare, vrasje kjo e udhhequn prej atij të cilin Qezari e donte më të fortin, Markus Brutus.

Disa politikanë mund t'a abuzojnë pathosin, p.sh., s'pari ata flasin keq për kundërshtarin, pastaj i kërkojnë audiencës të votojë kundër tij; ose s'pari ata flasin mirë për personin, pastaj i kërkojnë audiencës të votojë për të. Në këtë kategori hyjnë edhe oficerët e ushtirve. Ata e përshkruajn anmikun kaq ligsisht saqë ushtarët mund të ndjehen sikur eliminimi i cilitdo ushtar kundërshtar përban një shërbim ndaj të mirës njerzore.

Këta shembuj tregojnë që pathosi mund të përdoret me manipulua vullnetin e masave. Kjo e vërtetë mbështetë asertën që retorika është e ngujuome në emocione dhe që funksioni i saj është manipulimi i masave. Por, kjo pikpamje është sipërfaqësore. Retorika, dhe pathosi si pjesë e saj, ka edhe funksione të tjera.

2. Retori duhet të dijë edhe çka mos me thanë. Ka herë kur kyçja e gojës ka më vlerë se hapja e saj. Figurat publike e zbatojnë këtë të vërtetë me fanatizëm të madh. Prandaj, është shumë e vështirë me gjetë kumte ku politikanët ofendojnë pasuesit e tyne.

Aristoteli rekomendon retori duhet t'i bajë vetes trí pyetje.

1. Në çfarë **kondite** audiencia ndjen një emocion të caktuom?
2. Kundër **kujt** zëmrohet audiencia?
3. Për çfarë **arsyesh** zëmrohet audiencia?

Shembull prej viteve 1911-12

1. Çfarë kondite i zëmronte Lekët? *Mungesa e armëve.*
2. Kundër kujt zëmroheshin ata? *Osmanlive vendas e të huaj.*
3. Përse zëmroheshin ata? *Sepse pa armë ata s'mund të mbronin as veten, as familjet, as atdheun.*

Shembull prej kthimit të Gjergj Kastriotit:

1. Çfarë kondite i zëmronte shqiptarët? *Pushtimi.*

2. Kundër kujt zëmroheshin ata? *Pushtuesve.*

3. Përse zëmroheshin ata? *Sepse u mungonte liria.*

Fjalimi i Kastriotit: *Lirinë nuk ua pruna un. Atë e gjeta mes jush.*

Tipikisht, oficerët përpiqen t'i bindin ushtarët jo vetëm që ata kanë të drejtë të zemrohen, por edhe që që anmiku meritont një dënim të randë.

Në pikën #2 të Memorandumit të Parë të Lekëve (1883), shkruhet:

Vetëm kur na u siguruom se e njëjta qeveri krabinore po kompletonte pashpirtnisht dhe me mungesë të plotë njerzje me cak që të kryente shkatërrimin tonë; kur vendosi të shkelte me kambë ligjet tona tradicionale, kur urdhnoi masakrimin e Lekëve tanë paqsorë; kur ndërmoi shëndërrimin arbitrar të pronave tona, kur fyeu nderin e grave tona; kur kërcënoi jetën e bashkëkombasve tanë -- qytetarëve të frikësuom të qytetit të Shkodrës-- dhe së fundmi, kur dërgoi kundër nesh njëriç të armatosun me na sulmuu me armë; vetëm atëherë na e ndjemë veten të justifikuom t'i kundërpërgjigjemi dhe të zmbrahsim me armë dhunën që na u imponua.

Me këtë pikë Lekët e paraqesin veten si viktimat të otomanëve. Si persona të civilizuom që kanë gjithçka që e mundun të shmangnin luftën. Dhe në fund të fundit, kur ata sulmuon e thyen otomanët, kjo ishte një luftë fatkeqe, një dënim që otomanët e meritonin plotsisht sepse ata ishin tregom barbarë.

Me këtë Memorandum, Lekët kërkonin ndërhyemjen e Fuqive të Mëdha me ndalua sulmet e otomanëve në Vilajetin e Shkodrës, por veçsisht në zonën e tyne.

Trekandëshi Retorik

Kjo paraqitje grafike është një metodë e thjeshtë me kuptua apelet bindëse, gjithashtu të njohuna edhe si 'apelet retorike'. Trekandëshi retorik mund të quhet edhe trekandëshi Aristotelian sepse ai është nxjerrun prej mësimave të Aristotelit në veprën e tij *Retorika*. Aristoteli e ndan këtë vepër në tri pjesë a libra.

Libri I^{rë}

Këtu përcaktohet retorika, diskutohen caqet e saj, dhe febrohen farët kryesore të retorikës.

Libri II^{të}

Kjo pjesë u përkushtohet tri mjeteve të bindjes (apeleve retorike): ethosit, pathosit, dhe logosit.


1. ethosi (karakteri i autorit) – Besa, dija ose ekspertiza, përvoja, dhe besimi ose kredibiliteti që audienca ka në ligjruesin, shkruesin, a artistin.

2. logosi (vlera e argumentit) – logjika, arsyetimi, vërtetsia e evidencës, fakteve, e statistikave; zgjedhja e sinqertë ose jo e detajeve.

3. pathosi (emocionet e audiencës) – emocionet ndahen në dy kategori krejsore: drojën dhe dojën. Droja përfaqson atë që audienca dron; doja, atë që audienca don.

Po t’a shohim një ligjratë a vepër si të ndame në tri pjesë—fillimin, zhvillimin, dhe përfundimin—atherë mund të argumentohet që *fillimi* përkon me ethosin; *zhvillimi* me logosin; dhe *mbyllja* me pathosin. Autori prezanton vetveten në një dritë pozitive, dhe kështu fiton besimin e audiencës (ethos); zhvillon projektin në mënyrë logjike (logos); dhe e mbyllë projektin me një ligjratë emocionale (pathos).

Trekandëshi Aristotelian i Apeleve Retorike



Libri III^{të}

Këtu flitet për elementet e stilit, ku përfshihen zgjedhja e fjalëve e frazave, struktura e fjalisë, si dhe renditja (en. arrangement) e ligjratës.